



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 26/18
Prishtinë, më 6.6.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Ali Lajçi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuqi dhe Fikrim Damka.

Munguan: Dardan Molliqaj dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Fatmir Gashi – Zv.Ministër i Financave (MF), Ahmet Ismaili - Drejtori i Thesarit në MF, Milaim Aliu - Udhëheqës i Divizionit të Buxhetit Qendror në MF, Faruk Rrahmani – Udhëheqës i Departamentit të Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), Valbona Bytyqi – Ndihmës Auditor i Përgjithshëm në ZKA, Idriz Blakaj – Drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK), Besim Mulaj nga AMKMK, Shafi Gashi - Kryetair i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë (KKTK), Hilmi Demolli nga KKTK, Bujar Sadiku nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP),

Pjesëmarrësit tjerë: Albulena Avdiu- Gazetare nga Ekonomia Sot, Amire Qamili – Gazetare nga Birn.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Iseini, Dashurije Canolli dhe Luljeta Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhje e mbajtur e Komisionit, dt. 24.05.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2017;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017;**

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe amendamenteve të komisionit funksional për Administrate Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media;
9. Shqyrtimi i Kërkesës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e shumës së pagesës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Propozojë me shtye pikën e 9 të rendit të ditës për një mbledhje tjetër. Kemi nevojë për ti marrim disa informata nga administrata dhe të bëjmë disa krahasime me agjencitë tjera të pavarura.

Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht vendosi për shtyerjen e pikës 9 të rendit të ditës, për një mbledhje tjetër.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhje e mbajtur e Komisionit, dt. 8.05.2018

Kryetari: Konstatoi se procesverbali miratohet unanimisht pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryetari: Ja kalojë fjalën zv. ministrit për prezantimin e raportit.

Fatmir Gashi: Gjithsej pranimet e realizuara gjatë vitit 2017, duke përfshirë edhe fondet në mirëbesim dhe donacionet ishin 1,923 miliard euro dhe paraqesin 8% e pranimeve. Krahasuar me vitin paraprak kishte rritje për 8%. Ndërsa, gjithsejt pagesat e realizuara, duke përfshirë fondet e mirëbesimit dhe donacionet ishin 1,837 miliard euro dhe paraqesin 95% e pagesave të përgjithshme vjetore, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar rritje prej 4 %. Bilanci i fondeve me 31.12.2017 ishte 357 milion e 800 mijë euro, me një deficit prej 0.8% të BPV-së. Sa i përket strukturës së të hyrave, të hyrat direkte ishin 238 milion euro, të hyrat indirekte ishin me shume se 1,315 miliard euro, të hyrta tatimore 186 milion euro, huamarrje shtetërore dhe nënhuazimet 212 milion euro, grandet e percaktuara të donatorëve 8 milion euro, ndërsa kthimet tatimore 57.6 milion euro. Sa i përket strukturës institucionale, doganat kanë mbledhur 1,121 miliard euro dhe paraqesin 58% e të hyrave të përgjithshme dhe 7% më shumë se viti paraprak. Administrata Tatimore ka mbledhur 440 milion euro, duke përfshirë të hyrat e njëhershme prej 11 milion euro dhe marrin pjesë me 22% e të hyrave të përgjithshme dhe 98% e realizimit të planit vjetor dhe 7% rritje krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat jotatimore ishin 186 milion euro dhe paraqesin 10% e totalit të përgjithshëm apo 92% e realizimit të planit. Të hyrat vetanake të komunave ishin 66 milion euro, ku tatimi në pronë shënojë rritje prej 11% krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat nga taksa koncesionare 8.5 milion euro, nga renta minerare 30.6 milion euro. Të hyra nga dividenda nuk ka pasur, ndërsa kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike 9.35 milion euro. Të hyrat nga huazimet financiare ndërkombëtare ishin 108,25 milion euro, pranimet nga nënhuazimet 8,38 milion euro, nga letrat me vlerë 95,3 milion euro.

Shpenzimet në total ishin 1,837 miliard euro. Sa i përket strukturës: shpenzimet për paga dhe mëditje ishin 551 milion euro dhe paraqesin rritje prej 1% krahasuar me vitin paraprak, mallrat dhe shërbimet 204 milion euro dhe paraqesin një rritje prej 11% , shpenzimet komunale 24 milion euro dhe një rritje

prej 1%, subvencionet dhe transferet 508 milion euro, shpenzimet kapitale 470 milion euro. Gjendja e bilancit bankar në llogarinë rrjedhëse në BQK ka qenë 340 milion euro,

Kryetari: Në bazë të të dhënave në raport janë diku 569 e të punësuarve jashtë planifikimit buxhetor në nivel qendrorë 461 dhe në nivel lokal janë 596 të punësuar dhe po flasim për mbi 1,000 të punësuarish pa buxhet të planifikuar, si ka ndodhur kjo gjë?

Milaim Aliu: Në vitin e kaluar ka qenë një rregull, se për çdo punësim nga organizatat buxhetore, paraprakisht, është dashur të merret leja nga Ministria e Financave, për të verifikuar se mjetet janë të planifikuara në buxhet.

Fatmir Gashi: Theksoi se mjetet kanë qenë të parapara në buxhet për të gjithë të punësuarit dhe nuk ka tejkalime.

Safete Hadergjonaj: Mua po më intereson se këta të mbipunësuar, a janë me kontrata mbi vepër që janë paguar apo janë të punësuar në mënyrë të rregullt. Nuk ka logjikë që një komunë e vogël me pas 72 njerzë me kontrata mbi vepër.

Fatmir Gashi: Të punësuarit janë me kontrata mbi vepër dhe paguhet prej mallrave dhe shërbimeve.

Faruk Rrahmani: Këta të punësuarish janë jashtë listës së pagave dhe të angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta.

Kryetari: Sa për informim 8 milion euro është kostoja e qirasë që paguhet nga institucionet shtetërore dhe këtë çështje është dashur me zgjidh.

Pas diskutimit dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni me shtatë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017.

4. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017

Kryetari: Fillimisht ta trajtojmë projektin e Komunës së Istogut për Memorialin Ibrahim Rugova në shumë prej 200,000 euro. Sipas procesverbalit të komisionit, në bazë të shqyrtimit të kërkesës së Komunës së Istogut, tregohet qartë se projekti dhe mjetet janë ndarë për Projektin e Memorialit Ibrahim Rugova në Komunën e Istogut. Agjencia pretendon se mjetet janë ndarë për projektin e ngjashëm në Prishtinë. Pra, kemi të bëjmë me një projekt të ri me kode të reja buxhetore, gjë që e ka konfirmuar edhe Ministria e Financave.

Idriz Blakaj: Si Agjenci ne kemi kërkuar 500,000 euro për Projektin Memorial Ibrahim Rugova në Prishtinë. Kërkesa ka qenë e Komunës së Istogut, por mjetet janë ndarë në kodin e projektit të Prishtinës. Ne jemi përgatitur me shpall tenderin për Prishtinë, pasi që përputhet me titullin e këtij projekti.

Kryetari: Ne si komision nuk kemi pasur ndonjë kërkesë prej Agjencisë. Ne kemi pranuar kërkesën nga Komuna e Istogut dhe e kemi përkrahur projektin në shumë prej 200,000 euro dhe si amendament është miratuar në Kuvend.

Naser Osmani: Si duket është bërë një keqkuptim, mjetet kanë shkuar ku nuk është dashur. Ne kur miratojmë kërkesa që kanë të bëjnë me komunat, për shkak të formulës së grandave nuk i vendosim në buxhetin e komunave, por në nivelin qendror. Në këtë rast, projekti për Memorialin Ibrahim Rugova është për Istog dhe i vendosur në buxhetin e Agjencisë. Komuna e Istogut po ashtu ka pasur një projekt tjetër që është përkrahur nga komisioni që është vendosur në Ministrinë e Ambientit.

Idriz Blakaj: Pyeti çfarë duhet të bëjë Agjencia në këtë rast dhe për këtë projekt?

Kryetari: Theksoi se konform vendimit të Komisionit dhe Kuvendit dhe sipas Ligjit të Buxhetit, ju duhet që mjetet prej 200,000 euro ti realizoni për Projektin e Kompleksit Memorial Ibrahim Rugova, në Komunën e Istogut.

Fatmir Gashi: Theksoi se kjo është e qartë, pasi që kërkesa ka ardhur në komision për 200,000 euro për Memorialin Ibrahim Rugova në Istog dhe si të tillë e ka aprovuar Kuvendi. Projekti e ka kodin e ri buxhetor.

Naser Osmani: Theksoi se Agjencia mundet me bë një memorandum mirëkuptim me Komunën e Istogut për ti transferuar mjetet dhe ndërtimin e bënë komuna sepse janë kryer 80% e punëve. Përgjegjësia e Agjencisë mbetet pastaj për mirëmbajtjen e projektit.

Milaimi Aliu: Sqaroi se për tu transferuar mjetet në komunë, duhet me marrë vendim Kuvendi, sepse ligji thotë duhet aprovim paraprak prej Kuvendit.

Kryetari: Duhet arritur një memorandum i mirëkuptimit në mes Agjencisë dhe Komunës së Istogut dhe me u realizue projekti. Tani kërkojë nga Agjencia të prezantojë raportin vjetor financiar 2017.

Idriz Blakaj: Agjencia është formuar në vitin 2013, dhe me ligj parashihet ti kemi 52 punëtor, ndërsa i kemi vetëm 13 të punësuar. Pra kemi mungesë stafi dhe vazhdimisht kemi bërë kërkesa për rritje të stafit. Të dhënat për shpenzimet i keni në raport.

Besimi Mulaj: Sa i përket buxheti në fillim të vitit 2017 ishte 3,911,878 euro, me rishikim është zvogëluar në 2,872,878 euro. Më pas prezantoi shpenzimet sipas kategorive ekonomike, ndryshimet që kanë ndodhur me rishikimin e buxhetit dhe buxhetin final.

Faruk Rrahmani: Kheksoi ZKA ka kryer raportin e auditimit për këtë Agjenci. Në përgjithësi sa i perketë menaxhimit, në agjencion ka kontrole të mira në proces të mirë të rishikimit në sigurin dhe zbatimin e legjislacionit. Nga të gjetura është se mbi 190,000 mi euro të cilat nga natyra janë shpenzime të mallrve dhe shërbimeve janë shpenzuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Si ZKA jemi fokusuar në rekomandimet që ke nevojë për përmirësimin e menaxhimit të projekteve të cilat në vazhdimësi kanë pasur punë shtesë, ku pasur projekte me mbi 170,000 euro. Si dhe lidhur me funksionimin e sistemit E pasuria, për nevojën e përdorimit e tij.

Kryetari: Kërkojë sqarim prej Agjencisë për shumën prej 170,000 euro?

Besimi Mulaj: Sqaroi se kjo çështje ka të bëjë me atë që Ministria e Financave, projekt kodin e ka ndarë për kapitale dhe ajo paguhet nga mallrat dhe shërbimet. Ne kemi bërë kërkesë që tri vite, që të rregullohet kjo por ministria e ka lënë për investime kapitale.

Faruk Rrahmani: Për nga natyra ky kod është për mallra e shërbime dhe sipas raportimit nuk e plotëson asnjë kriter për investime kapitale.

Fikrim Damka: Po me intereson kjo për pasijet që keni shumën 31,000 euro, çfarë është?

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, për vitin 2017.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017

Kryetari: Kryetari nga përfaqësuesit e Këshillit të paraqesin raporti dhe pastaj auditorët raportin e auditimit.

Shafi Gashi - Këshilli ka pasur një buxhet të mirë, për mallra dhe shërbime nuk është shpenzuar në tërësi. Po ashtu edhe në paga kemi pasur mosshpenzim për shkak të zgjedhjes së vonshme të Këshillit. Ne kemi disa monumente në gjendje të keqe, sidomos në rrafshin e dukagjinit dhe si rezultat kemi nevojë për staf specialistë të fushës arkeolog, arkitekt të artit.

Hilmi Demolli – Këshilli ka një një buxhet prej 200,000 euro të ndare në tri kategori: në paga e mëditje, mallra e shërbime edhe shërbime komunalit. Shpenzime kapitale e subvencione nuk ka pasur asnjëherë, tek mallrat dhe shërbimet është në shumë prej 85,000 eurove.

Faruk Rrahmani: Opinioni i auditorit është i pamodifikuar. Menaxhimi i buxhetit ka qenë 80% që e ka shkaktuar niveli i ulët i mallrave dhe shërbimeve të cilin ka qenë vetëm 58%. Mangësi tjera kemi identifikuar tek personeli edhe të menagjimi i pasurive.

Safete Hadërgjonaj: Sa i përket kategorisë për paga dhe mëditje, por shfiet se nuk i keni plotësuar 3 vende të punës, ndërsa në raport keni prezantuar se keni shpenzuar 99.3% për këtë kategori. Nëse nuk i keni rekrutuar 3 punëtor, si është realizuar buxheti në këtë shumë prej 99.3%. Në fakt në bazë të raportit po më lënë përshtypje se i keni të plotësuar të gjithë pozitat pasi që keni realizuar buxhetin për paga dhe mëditje, ndërsa po del në kontradiktë që keni thënë se janë 3 punëtor të pa plotësuar.

Hilmi Demolli: Theksoi se në fund të vitit 2016, komisioni për buxhet e ka nxjerr një vendim, ku pagat e anëtarëve të Këshillit janë rritur, për kryetarin 800 euro, zv.kryetarin 700 euro dhe për anëtarët 600 euro. Ky vendimi nuk është reflektuar në rritjen e buxhetit të këshillit në vitin 2017. Në mungesë të rekrutimit të punëtorëve dhe duke pasur parasysh vendimin e Kuvendit, është shpenzuar buxhetit për paga në atë shumë. Këtë vit kemi rekrutuar një dhe dy janë në proces. Po ashtu kemi edhe rritjen e buxhetit nga ministria e financave konform vendimit të Kuvendit.

Fikrim Damka: Po me intereson me dinë ligjërisht pagesa e mëditjeve brenda vendit që keni paguar?

Hilmi Demolli: Në bazë të ligjit për shërbimin civil, kemi të drejtë edhe në mëditje edhe brenda vendit. Natyra e punës së Këshillit është se kur i pranon dosjet për ti futur në mbrojtje të përhershme dhe është patjetër e nevojshme që të monitorojmë situatën apo monumentet. Specialisti verifikon monumentet në terren dhe këto janë shpenzime të terrenit.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin 2017.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017

Kryetari: Kërkojë nga përfaqësuesi i Agjencisë të paraqet raportin financiar për vitin 2017.

Bujar Sadiku: Sa i përket buxhetit të vitit kaluar në vazhdimsi buxheti ka qenë i njëjtë nëpër vite. Duke pasur parasysh faktin se në vitin 2017 ka qenë raportimi pesë shifror, nuk kemi pasur asnjë tejkalim. Në mungesë të Këshillit të Agjencisë, ne kemi kthyer buxhetin e tyre për paga në Ministrinë e Financave

Faruk Rrahmani - agjensioni ka pas 75% e buxhetit të realizuar për shkak të mos emërimit të antarëve të Këshillit. Çështjet tjera që duhet me u përmirësuar tek Agjencia është tek ndarja e detyrave, ku mungojnë disa pozita. Po ashtu duhet përmirësime në menaxhimin e personelit. Duhet me u rregulluar procesi i pagesave sipas arkave të përcaktuara me rregullat e thesarit, menaxhimi i pasurisë dhe ne kemi nxjerrur 8 rekomandime, 4 prej tyre i ka zbatuar plotësisht, 3 janë në proces të zbatimit edhe 1 nuk është plotësuar fare dhe kjo ka të bëjë me pagesat sipas rregullave të thesarit.

Bujar Sadiku: Në vitin 2017 i kemi 5 rekomandime të auditimit dhe pasqyrat kanë qenë të qarta, përkundër mungesës së kyqjes së disa zyrtarëve kyqë si zyrtar certifikues dhe i prokurimit. Si rezultat ne është dashur të angazhojmë zyrtarët për të kryer këto punë apo edhe të kërkojmë shërbime nga institucionet tjera. Kjo ka ndikuar edhe në çështjen e menaxhimit financiar. Sa i përket menaxhimit të personelit, në muajin dhjetor ka qenë një rast pa pagesë, në muajin mars ka dhënë dorëheqje që nuk i ka plotësuar të gjitha dokumentet përcjellëse.

Fikrim Damka: Shpenzimet për paga e mëditje janë 117,000 euro dhe 30% janë mëditje jashtë Kosove. Kjo shumë është e lartë krahasur me pagat dhe mëditjet?

Bujar Sadiku: Sa i përket pagave në Agjenci, i kemi sikurse çdo ministri. Sa i përket mëditjeve zyrtare, në Agjenci janë shtuar edhe dy obligime shtesë që është cekur edhe në raportin e punës sepse Agjencia është anëtare e iniciativës së agjencive të ngjashme që është iniciuar nga autoriteti slloven dhe është lidhur marrëveshja me shtetet e ish-Jugosllavisë dhe kemi obligime për pjesëmarrje në grupet punuese të përbashkëta dhe studime të rasteve të përbashkëta. Po ashtu jemi anëtare e Konferencës Evropiane dhe kemi obligime për pjesëmarrje dhe prezantime në grupet e punës në takimet që mbahen jashtë vendit.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2017.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Kryetari: Në bazë të opinionit të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe amendamenteve të komisionit funksional për Administrate Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media

Kryetari: Tek ky Projektligj, kemi një çështje tek amendamenti 3 i komisionit funksional, ku thuhet se Këshilli e dërgon buxhetin direkt në Kuvend. Me qëllim të harmonizimit me Ligjin për Memanxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë sa përket procedurës dhe fazave të buxhetit, propozojë që të propozojmë një amendament dhe të ndryshojmë paragrafin 2 të nenit 27, me këtë përmbajtje “Këshilli përgatit propozim buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë”. Si rezultat, amendamenti 3 i komisionit funksional për këtë çështje duhet të fshihet.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të paragrafit 2 të nenit 27.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendament në Projektligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 27, paragrafi 2 ndryshohet me tekstin si vijon:

2. Këshilli përgatit propozim buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, për Projektligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga deputeti Armend Zemaj, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.
4. Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që të fshihet amendamenti 3, i propozuara nga Komisionin FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, pasi që ndryshon të njëjtën çështje, në paragrafin 2 të nenit 27, për të cilën Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka propozuar amendamentin 1, si më lartë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku